



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 5-të të KPF-së Lipjanit mbajtur, më 29.06.2026, në sallën numër 2 , kati i 3-të , me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Armend Grajçevci, anëtar
3. Anila Reçica - Llugiqi, anëtare
4. Elmaze Behluli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Gashi, anëtare
7. Alban Salihu anëtar

Të tjerë prezent :

1. Rasim Hasani, DKA
2. Sead Aliu, DSHPMM
3. Burim Rrustemi, DKRS
4. Latif Ramadani, DBF
5. Imri Semetishti DPUMM

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës se bashku me material e keni marrë me kohë të cilin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 4-të e KPF-së.
2. Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2025.
3. Propozim Vendim mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2024 dhe 2025 në vitin 2026.

4. Propozim Vendim mbi aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029.
5. Propozim Rregullore për taksat dhe gjobat komunale.
6. Propozim Vendim për miratimin e Planit të Transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Lipjanit 2026-2030.
7. Propozim Vendim për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit.
8. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer për subvencionimin e qumështit Nr.320/01-26973 i datës 16.06.2026.
9. Propozim Vendim për ndryshimin e titullarit të paluajtshmërisë nga Shkolla Bujqësore në Shkollën e Mesme Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan.
10. Propozim Vendim për ndryshimin e titullarit të paluajtshmërisë nga Shkolla Bujqësore në Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "Vëllëzrit Frashëri" në Lipjan.
11. Propozim Vendim për përcaktimin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Pastrimi".
12. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan, për Vendimin paraprak 15NR.463/02-17208 i datës 29.03.2024 dhe Vendimin NR.15-462/01-22762 të datës 08.05.2024 për korrigjimin e Vendimit paraprak.
13. Propozim Vendim për anulimin e Vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës në Zonën Kadastrale Lipjan 15NR.462/01-20084 të datës 30.04.2026.

Meqë vërejtje as plotësime nuk pati Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi rendin e ditës me pikët e propozuara.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 4-të e KPF-së.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth ekstraktit.

Meqë diskutime as vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi ekstraktit nga mbledhja e 4-të e KPF-së.

II

Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2025.

Arsim Jashari, tha se propozoj që pika 2,3 dhe 4 të kalojnë direkt për Kuvend.

Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2025.

Propozim Vendim mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2024 dhe 2025 në vitin 2026.

Propozim Vendim mbi aprovimin e Kornizes Afatmesme Buxhetore 2027-2029

Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

Pastaj u kalua në pikën në vazhdim.

V

Propozim Rregullore për taksat dhe gjobat komunale.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit, drejtor i DEZH i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se këtë pikë e kemi diskutuar para gati dy muajve në KPF, ndërsa në Kuvend u tërhoq nga reni i ditës me propozim të LDK-së, nuk u ditë arsyjeja pse u tërhoq. Tani vjen prapë dhe ndryshohet pa dal fare në diskutim publik dhe pa qenë të njoftuar ne anëtarët e Kuvendit.

Armend Grajqevci, tha po ne pas mbajtjes së mbledhjes së KPF-së dhe takimit me grupin e LDK-së kemi ardh në përfundim që kjo rregullore të tërhiqet nga rendi i ditës dhe të bëhet një rregullore e veçantë për parkingje.

Valon Pacolli, tha se ne për parkingje do të bëjmë një rregullore të veçantë.

Arsim Jashari, tha nuk po me doket e arsyeshme me bo këtë pa e qit në diskutim publik pastaj edhe ne anëtarët me qenë të njoftuar sepse në mbledhjen e fundit edhe ne kemi votuar mu tërhoq ajo rregullore.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

VI

Propozim Vendim për miratimin e Planit të Transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Lipjanit 2026-2030.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rustemit, Drejtor i Shërbimeve Publike , i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

VII

Propozim Vendim për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetshti DPUMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se a mendon qe do të na kthehet pozitiv nga MAPL ky vendim.

Imri Smetishti, tha se unë kam besim që kjo do të kthehet pozitiv si vendim nga MAPL.

Alban Salihu, tha se një rrugë është me emrin ishulli i Sazanit a e keni parë.

Imri Semetshti, tha është emra rezerve për rrugë ashtu është i propozuar nga qytetarët.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

VIII

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer për subvencionimin e qumështit Nr.320/01-26973 i datës 16.06.2026.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

IX

Propozim Vendim për ndryshimin e titullarit të paluajtshmërisë nga Shkolla Bujqësore në Shkollën e Mesme Gjimnazi “Ulpiana” në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Rasim Hasanit drejtor i DKA-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

X

Propozim Vendim për ndryshimin e titullarit të paluajtshmërisë nga Shkolla Bujqësore në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Rasim Hasanit drejtor i DKA-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

XI

Propozim Vendim për përcaktimin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Pastrimi".

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Sead Aliu, DSHPMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

XII

Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan, për Vendimin paraprak 15NR.463/02-17208 i datës 29.03.2024 dhe Vendimin NR.15-462/01-22762 të datës 08.05.2024 për korrigjimin e Vendimit paraprak.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi ia kaloi fjalën Imri Semetishti nga DPUMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Alban Salihu, tha se unë mendoj që këtu prapë ka me dështuar pasi që herën e parë e kam marr avokati personal i komunës dhe në bazë të do informatave që i kam nga disa qytetarë aty nuk do të këtë marrëveshje.

Arsim Jashari, tha se ato objekte me të vërtetë janë në gjendje të keqe dhe nuk e di se si jetojnë aty qytetarët. Më pëlqeu shumë propozimi që të dal një komision dhe të shikoj gjendjen e atyre objekteve dhe vlersimin e gjendjes në teren.

Imri Semeteishti, tha se unë do të bëjë më të mirën e qytetarëve dhe nuk do të merrem se çka diskutohet. Ndërsa sa i përket objekteve është shpall një tender në prokurim po do të dal një komision në teren dhe do të shikoj gjendjen e atyre objekteve në afat brenda 35 dite.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

XIII

Propozim Vendim për anulimin e Vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës në Zonën Kadastrale Lipjan 15NR.462/01-20084 të datës 30.04.2026

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rustemit, drejtor i DKRS i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se duhet me qenë më të kujdesshëm se për shkak të një gabimi teknik apo gabimi tjetër po na shkon gati 6 muaj dhe po kthehemi në pikën zero.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:30

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i KPF-së

Daut Azemi